



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0012

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi – Kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “FST ENGINEERING” SH.P.K. kundër Vendimit për dhënie të një kontrate ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Hartimi i projektit kryesor i objektit administrativ komunal – Peje me numër të prokurimit: 635-24-6877-4-2-3, me 12/03/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “FST ENGINEERING” SH.P.K. me nr. 2025/0012 , e datës 03/01/2025 kurse vendimi i AK Komuna e Pejës lidhur me aktivitetin e prokurimit Hartimi i projektit kryesor i objektit administrativ komunal – Peje me numër të prokurimit: 635-24-6877-4-2-3 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “FST ENGINEERING” SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Hartimi i projektit kryesor i objektit administrativ komunal – Peje me numër të prokurimit: 635-24-6877-4-2-3.

Me 22.12.2024, OE “FST ENGINEERING” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 24.12.2024 , Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.01.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "FST ENGINEERING" SH.P.K. me nr. 0012/2025 lidhur me aktivitetin Hartimi i projektit kryesor i objektit administrativ komunal – Peje me numër të prokurimit: 635-24-6877-4-2-3.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "FST ENGINEERING" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1 :Në Detyrën Projektuese për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për: Objekti administrativ Komunal ~ Komuna e Pejës, tek B. Ndërtesa - Pjesa për staf, është kërkuar që të parashikohet "Holli i hyrjes me hapësirë për pritje". Në projektin e propozuar nga Kodi 1620, vihet re se kjo përmbajtje e kërkuar nuk është parashikuar, pasi mungon hapësira për pritje.

Pretendimi 2 :Në Detyrën Projektuese për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për: Objekti administrativ Komunal ~ Komuna e Pejës, tek B. Ndërtesa - Pjesa për staf, është kërkuar që të parashikohet "Hapësira për dosje dhe arkiva për ruajtjen e dokumenteve". Në projektin e propozuar nga Kodi 1620, vihet re se kjo përmbajtje e kërkuar në detyrën projektuese nuk është përfshirë në projektin e dorëzuar.

Pretendimi 3: Në Detyrën Projektuese për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për: Objekti administrativ Komunal - Komuna e Pejës, tek B. Ndërtesa - Pjesa për staf, është kërkuar që të parashikohet "WC dhe garderoba për personelin". Në projektin e propozuar nga Kodi 1620, vihet re se kjo përmbajtje e kërkuar nuk është parashikuar, pasi mungojnë garderozat për personelin.

Pretendimi 4:Në Detyrën Projektuese për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për: Objekti administrativ Komunal - Komuna e Pejës, tek C. Ndërtesa - Pjesa teknike, është kërkuar që të parashikohet "Hapësira për mirëmbajtje". Në projektin e propozuar nga Kodi 1620, vihet re se kjo përmbajtje e kërkuar në detyrën projektuese nuk është përfshirë në projektin e dorëzuar.

Pretendimi 5:Në Detyrën Projektuese për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për: Objekti administrativ Komunal - Komuna e Pejës, tek C. Ndërtesa - Pjesa teknike, është kërkuar që të parashikohet "Kthina teknike". Në projektin e propozuar nga Kodi 1620, vihet re se kjo përmbajtje, e cila është shumë e rëndësishme për funksionimin e rregullt të objektit, nuk është përfshirë në projektin e dorëzuar.

Pretendimi 6:Në Detyrën Projektuese për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për: Objekti administrativ Komunal - Komuna e Pejës, tek B. Ndërtesa - Pjesa për staf, është kërkuar që të parashikohen kthinat:

- Sistemet e sigurisë, duke përfshirë kamerat e mbikëqyrjes dhe kontrollin e hyrjeve
- Sistemet e komunikimit dhe teknologji informatike për menaxhimin e informacionit dhe komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm

Në projektin e propozuar nga Kodi 1620, vihet re se këto përmbajtje të kërkuara në detyrën projektuese janë parashikuar vetëm me një zyrë, ndërkohë që në detyrën projektuese është e qartë kërkesa që të jenë zyra të ndara nga njëra-tjetra.

Pretendimi 7: Në Detyrën Projektuese për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për: Objekti administrativ Komunal - Komuna e Pejës, tek Përmbajtja e Projektit, është kërkuar "Kostoja e përafërt e ndërtimit me paramasë". Në paramasën e dorëzuar nga Kodi 1620 janë të shënuara vetëm përshkrimet e pozicioneve të punëve, por nuk ka asnjë vlerë për pozicion apo vlerë totale të koston së përafërt të ndërtimit. Kjo bën që paramasa të dorëzuar të jetë e pavlefshme. Pavarësisht kësaj, kjo "Paramasë" e cila nuk tregon asnjë kosto të përafërt të ndërtimit është vlerësuar nga juria profesionale me 96.67 pikë.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim: Rrethanat procedurale dhe faza e shqyrtimit paraparak.

Operatori Ekonomik ME KODIN 1610, FST Engineering SH.P.K., më datën 23.12.2024, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Prok: Hartimi i Projektit Kryesor të Objektit Administrativ Komunal - Pejë, Rishikim** me Nr. të Prok: **635-24-6877-4-2-3** dhe Nr. i **635-24-045-423**.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Autoriteti Kontraktues, më datën 24.12.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka arritur në përfundimin si më poshtë: "Duke iu referuar ankesës tuaj të dorëzuar më datën 23.12.2024, **Autoriteti Kontraktues (AK)** ka shqyrtuar me kujdes pretendimet dhe dokumentacionin e paraqitur. Pas një analize të detajuar, ju njoftojmë se ankesa juaj është konsideruar **e pavlefshme dhe e pabazuar**, për arsyet e mëposhtme:

1. **Mospërputhja e Operatorëve Ekonomikë (OE):** Më datë 30.08.2024, ju keni dorëzuar një kërkesë për rishqyrtim në emër të Operatorit Ekonomik **PRIMO STUDIO SH.P.K.** Ankesa juaj e datës 23.12.2024, megjithatë, është paraqitur në emër të një Operatorit Ekonomik tjetër, **FST Engineering SH.P.K.** Kjo përbën një mospërputhje të rëndësishme, pasi ankesa nuk është paraqitur nga i njëjti Operator Ekonomik që ka dorëzuar ofertën.
2. **Kodi i njëjtë i ofertës:** Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, u konstatua se të dy Operatorët Ekonomikë, **PRIMO STUDIO SH.P.K.** dhe **FST Engineering SH.P.K.**, kanë përdorur të njëjtin kod të ofertës. Ky fakt është një shkelje e rregullave dhe procedurave të shqyrtimit të ankesave, duke çuar në pavlefshmërinë e ankesës së dytë.
3. **Rregullat për shqyrtimin e ankesave:** Sipas rregulloreve dhe udhëzimeve të vlefshme për procedurat e shqyrtimit të ankesave, çdo ankues duhet të paraqesë një kërkesë të saktë dhe të përputhshme me dokumentacionin dhe Operatorin fillestar që ka dorëzuar ofertën. Në rast të kundërt, ankesa konsiderohet e pavlefshme dhe nuk mund të shqyrtohet më tej.

Vendimi i AK: Duke marrë parasysh rrethanat e mësipërme, **Autoriteti Kontraktues** ju njofton se ankesa juaj e paraqitur më datë 23.12.2024 është **refuzuar** si e pavlefshme dhe **nuk do të procedohet për shqyrtim të mëtejshëm**.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e lartpërmendura dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, ku shkruhet qartë: "Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve

kontraktuese në Kosovë.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 09/01/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0012/2025, ndërsa me datë 16/01/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0012, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me pretendimet e OE “FST ENGINEERING” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0012 ka vlerësuar si në vijim:

PRETENDIMET ANKIMORE

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK) ka shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullores përkatëse duke favorizuar ofertën me kodin 1620, pavarësisht mangësive të theksuara teknike. Ankesa thekson se vendimi paraprak i OSHP-së për rivlerësimin e ofertave nuk është respektuar, dhe juria ka dhënë pikë maksimale për një projekt që nuk përmbushte kërkesat e detyrës projektuese, duke përfshirë mungesën e hollit të hyrjes, garderobave, kthinave teknike, hapësirave për mirëmbajtje dhe ndarjes së sistemeve të sigurisë. Gjithashtu, paramasat e dorëzuara nga Kodi 1620 janë të paplota dhe nuk përmbajnë kosto të përafërta të ndërtimit. Ankuesi pretendon gjithashtu se AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim për arsye formale, duke mos adresuar pretendimet kryesore dhe duke e bazuar refuzimin në teknikalitete mbi përfaqësimin. Sipas ankuesit, kjo qasje tregon favorizim të hapur dhe potencial për manipulim në procesin e vlerësimit. Ankuesi kërkon që OSHP të miratojë ankesën dhe të urdhërojë një rivlerësim të drejtë dhe objektiv të ofertave sipas kriterëve të dosjes së tenderit dhe ligjeve në fuqi.

PËRGJIGJA E EKSPERTIT SHQYRTUES:

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit dhe veprimet e AK-së, duke paraqitur konstatimet dhe vlerësimet si më poshtë:

- Përgjigja e AK-së ndaj Kërkesës për Rishqyrtim:
Pas analizimit të dokumenteve në platformën e-Prokurimi, eksperti shqyrtues ka gjetur se në përgjigjen e datës 24.12.2024, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim duke u bazuar në çështje formale mbi përfaqësimin, duke pretenduar se kërkesa ishte bërë nga një subjekt tjetër dhe jo nga i njëjti operator ekonomik që kishte paraqitur ofertën fillestare. Për më tepër, AK nuk ka trajtuar pretendimet kryesore të ankuesit mbi mangësitë teknike të projektit me kodin 1620, duke argumentuar se kërkesa ishte e pavlefshme për shkak të mospërputhjeve formale, me arsyetimin se ankesa ishte bërë nga anëtari i dytë i konsorciumit.
Duke marrë parasysh nenin 108/A, paragrafi 5 të LPP-së, eksperti shqyrtues sqaron se kjo ishte një çështje procedurale dhe se AK kishte detyrimin ligjor të kërkonte sqarime ose plotësime nga ankuesi brenda dy ditëve për të korrigjuar çdo mospërputhje të pretenduar. Refuzimi i menjëhershëm i kërkesës për rishqyrtim, pa ndjekur këtë procedurë, bie në kundërshtim me detyrimet e qarta të përcaktuara në LPP dhe përbën mosrespektim të dispozitave ligjore. Ky veprim jo vetëm që shkel kërkesat procedurale, por gjithashtu tregon neglizhencë për trajtimin e pretendimeve thelbësore të ngritura nga ankuesi.

- Vendimi Paraprak i Panelit të OSHP-së (OSHP: 2024/0838): Paneli Shqyrtues i OSHP-së, në vendimin e datës 08.11.2024, kishte vlerësuar si të bazuara pretendimet e ankuesit mbi mangësitë e ofertës me kodin 1620. Eksperti shqyrtues sqaron se në këtë vendim, paneli kishte urdhëruar anulimin e njoftimit mbi vendimin e AK-së, sipas të cilit juria profesionale kishte vlerësuar maksimalisht projektin 1620, pavarësisht mangësive të dokumentuara. Paneli kishte kërkuar nga AK që çështja të rikthehej për rivlerësim të ofertave, duke u bazuar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura mbi mungesat teknike dhe paramasat e pavlefshme të projektit 1620. Vendimi i OSHP-së theksonte qartë nevojën për transparencë dhe drejtësi në vlerësimin e ofertave, duke vënë në dukje se juria kishte dështuar të respektojë këto parime gjatë procesit të vlerësimit të mëparshëm.
- Analiza dhe Vlerësimi i Mangësive në Projektin me Kodin 1620: Pas analizimit të procesit të prokurimit dhe dokumentacionit përkatës, eksperti shqyrtues ka gjetur se pretendimet e ankuesit janë të bazuara. Për projektin me kodin 1620, eksperti konstaton se mangësitë e theksuara, si mungesa e hapësirave të kërkuara në detyrën projektuese (holli i hyrjes, garderobat dhe kthinat teknike), mungesa e hapësirave për dosje dhe arkiva, hapësirat për mirëmbajtje dhe ndarja e papërshtatshme e sistemeve të sigurisë dhe teknologjisë së informacionit, si dhe paramasat e dorëzuara pa kosto të përafërta ndërtimi, janë evidentuar edhe në vendimin e mëparshëm të panelit shqyrtues me nr. 2024/0838. Eksperti vëren se dhënia e pikëve maksimale për një projekt që nuk përmbush këto kërkesa teknike dhe thelbësore është në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, i cili kërkon një vlerësim objektiv, të drejtë dhe transparent të ofertave. Gjithashtu, veprimet e jurisë janë në kundërshtim me nenin 80 të LPP-së, i cili përcakton se përbërja dhe vendimet e jurisë duhet të jenë të paanshme dhe profesionale. Favorizimi i një projekti me mangësi të dokumentuara tregon se juria nuk ka vepruar sipas këtyre parimeve të përcaktuara me ligj.

PËRFUNDIMI

Mbështetur në arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Në bazë të nenit 7 të LPP-së, AK nuk ka arritur të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jo-diskriminues të operatorëve ekonomikë, pasi projekti me kodin 1620 ka marrë përparësi pavarësisht mangësive teknike të evidentuara. Gjithashtu, veprimi i jurisë nuk është në pajtim me nenin 80 të LPP-së, pasi ajo nuk ka marrë vendime tërësisht objektive dhe profesionale, duke vlerësuar me pikë maksimale një ofertë që nuk përmbushte në mënyrë të plotë kërkesat teknike.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin Hartimi i projektit kryesor i objektit administrativ komunal – Peje me numër të prokurimit: 635-24-6877-4-2-3.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Hartimi i projektit kryesor i objektit administrativ komunal – Peje me

numër të prokurimit 635-24-6877-4-2-3, të anulohet njoftimi për dhenie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuara, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me titull Hartimi i projektit kryesor i objektit administrativ komunal – Peje me numër të prokurimit 635-24-6877-4-2-3 të kthehet në rivlerësim si dhe AK të veprojë në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - FST Engineering SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: